



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1322/7 prot.

Tiranë, më 01.08.2025

VENDIM

Nr. 24, datë 01.08.2025

PËR KONTROLLUESIN “PARTIA MUNDËSIA”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “*Partia Mundësia*” (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

1. Në zbatim të Urdhrit nr. 129, datë 20.06.2025, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:
 - “Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave E.Q., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, si dhe zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.”

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë Kontrolluesit, vëren se:

2. Partia Mundësia është parti politike e regjistruar me Vendimin Nr. 4, datë 19.09.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “anëtar/aktivistë”; “staf organizativ i partisë”; “palë të treta”; etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

3. Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), është përcjellë nëpërmjet postës elektronike, të datës, 04.05.2025, administruar me tonën me nr.1322 prot., datë 05.05.2025, ankesa e subjektit të të dhënave personale E.Q., nëpërmjet të cilës pretendon se, më datë 03.05.2025 i është dërguar në adresën e saj elektronike një email promovues nga Partia Mundësia, për të cilin ankuesja shprehet se nuk ka dhënë pëlqimin.

Nga verifikimi i e-mail-it bashkëlidhur ankesës, me dërgues adresën elektronike info@mundesia.al dhe marrës e*****@gmail.com, datë 03.05.2025, rezulton se komunikimi elektronik mbart në përmbajtje të tij një mesazh promovues mbi zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara më datë 11.05.2025.

4. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur, si dhe garantimit të përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, ka nxjerrë Urdhrin e Hetimit Administrativ nr. 129, datë, 20.06.2025, me objekt: “Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave E.Q., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, si dhe zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.”.

Grupi i inspektimit është paraqitur në datën 24.06.2025 pranë ambienteve të Kontrolluesit, duke bërë me dije qëllimin e hetimit administrativ në lidhje me verifikimin e ankesës dhe zbatimin e Ligjit.

Kontrolluesit, iu kërkua informacion dhe sqarime në lidhje me pretendimet e ankueses si dhe përpunimin e të dhënave personale për rastin konkret.

Gjatë hetimit administrativ, me përfaqësuesin e Kontrolluesit, u dakordësua që, dokumentacioni i kërkuar nga grupi i inspektimit, do të dërgohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare.

Në vijim, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 24.06.2025, me objekt “Kërkesë për Dokumentacion”, Kontrolluesit i është kërkuar që brenda datës 25.06.2025 të vendosë në dispozicion të Zyrës së Komisionerit dokumentacionin si vijon:

1. Rregullore e Brendshme për Funksonimin dhe Organizimin e “Partisë Mundësia”;
2. Rregullore për Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale;
3. Deklaratë konfidencialiteti;
4. Formular pëlqimi;
5. Lista e numrave në përdorim të Partisë Mundësia, bashkëlidhur kontratën;

6. Printscreen i postës elektronike zyrtare;
7. Procesverbal i asgjësimit i të dhënave personale;
8. Akte të brendshëm rregullatorë për përcaktimin e detyrave funksionale të strukturës organizative.
9. Si dhe çdo material/dokument tjetër që mund të lidhet me objektin e hetimit administrativ dhe që, Kontrolluesi e vlerëson të nevojshëm për ecurinë dhe përfundimin e këtij procesi.

Në përgjigje të komunikimit elektronik të datës 24.06.2025, Kontrolluesi me shkresën e datës 25.06.2025, ka përcjellë pranë Zyrës së Komisionerit dokumentacionin, si vijon:

1. Rregulloren për Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale;
2. Rregulloren e Brendshme për Funksionimin dhe Organizimin e Partisë;
3. Formularët e pëlqimit dhe deklaratat e konfidencialitetit;
4. Procesverbalin për asgjësimin e të dhënave;
5. Strukturën organizative me përshkrim bazik detyrash funksionale;
6. Lista e numrave në përdorim të Partisë dhe kontrata përkatëse;
7. Rregullore mbi aksesin, sigurinë dhe menaxhimin e aseteve;
8. Fakti që po ju kthejmë përgjigje nga kjo adresë emaili, konfirmon dhe posedimin e adresës info@mundësia.al, nga kjo parti.

Ndër të tjera, Kontrolluesi është shprehur se dokumentet e sipërcituara janë hartuar në përputhje me Ligjin dhe standardet e Rregullores së BE-së, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, propocionalitetit, ruajtjes së kufizuar, pëlqimit dhe llogaridhënies.

5. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit, në raport me Ligjin, nga grupi i inspektimit është mbajtur procesverbali i hetimit administrativ nr.1322/3 prot., datë 07.07.2025, i cili i është përcjellë Kontrolluesit me shkresën nr. 1322/5 prot., datë 07.07.2025, me lëndë “*Njoftim për pjesëmarrje në procesin e shqyrtimit administrativ*”.

Në rubrikën “*Përfaqësuesi i kontrolluesit parashtroi këto pretendime*”, të procesverbalit të hetimit administrativ nr. 1322/3 prot., datë 07.07.2025, përfaqësuesi i Kontrolluesit deklaroi se pretendimet lidhur me konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ, i ka parashtruar në shkresën e datës 10.07.2025.

Referuar përmbajtjes së shkresës së datës 10.07.2025, Kontrolluesi ka parashtruar se, ai e ushtron veprimtarinë si subjekt i së drejtës publike me veçanti të theksuar politike dhe organizative, por pretendon se nuk është autoritet publik apo ent administrativ në kuptim të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”). Sipas tij, referenca në Kodin e Procedurave Administrative për vlefshmërinë e dokumenteve të brendshme të një partie politike është e pambështetur në ligj, për sa kohë partia nuk ka detyrim të ndjekë formate dhe procedura që janë të rezervuara për institucionet publike. Aktet si rregulloret dhe politikat e brendshme të miratuara nga Partia Mundësia nuk kanë karakter aktesh administrative, por

akte organizative të brendshme, të cilat prodhojnë efekt vetëm ndaj anëtarëve dhe strukturave të saj dhe nuk janë të nënshtruara ndaj kritereve të formës apo miratimit formal sipas Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të Komisionerit dy urdhra, përkatësisht, Urdhrin nr. 1, datë 12.11.2024 *“Për miratimin e akteve rregullatore dhe normative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”*, si dhe Urdhrin nr. 3, datë 13.02.2025 *“Rregullore për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, të cilët, pretendon se, janë nënshkruar për miratimin e akteve të sipërcituar.

4. Në datën dhe orën e përcaktuar në shkresën nr. 1322/5 prot., datë 07.07.2025, konkretisht më datë 11.07.2025, ora 11:00 është paraqitur në seancën dëgjimore pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit, përfaqësuesi i Kontrolluesit, i cili pas relatimit të gjetjeve të konstatuara nga grupit i inspektimit, ndër të tjera deklaroi se: *“Në një nga mbledhjet e para të Sekretariatit të Përgjithshëm, më është lënë detyrë midis të tjerash të merrja masa për hartimin e akteve apo të zbatueshmërisë ndaj ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Kemi miratuar disa akte të cilat janë hartuar nga ana ime, dhe me një urdhr të datës 12.11.2024, këto akte janë miratuar dhe janë publikuar më përpara, sepse janë bërë më përpara gati, por në këtë datë kemi një formalizim. Ndërsa, për sa i përket një akti tjetër, i cili është shfuqizuar pas ligjit, konkretisht “Rregullorja për Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”, e cila ka pësuar një ndryshim në shkurt në mos gaboj. Është dhe akti tjetër për miratimin e saj dhe shfuqizimin e atij të mëparshëm, kështu që ne vlerësojmë që, rezulton e provuar që jo vetëm kanë qenë të miratuara nga pikëpamja formale, por kanë qenë dhe të publikuara në zbatim e sipër. Për sa i përket akteve të tjera siç janë formularët e pëlqimit, nuk kemi ndonjë akt për miratimin e tyre, por aktualisht ato zbatohen dhe aplikohen. Në lidhje me subjektin ankues, ne nuk na është vënë në dispozicion ndonjë emër mbiemër i subjektit ankues, por pavarësisht kësaj, sepse kjo ndoshta për shkak të sigurisë, informacionit dhe anonimizimit të të dhënave. Ne vlerësojmë, nuk pretendojmë që ndoshta nuk e kemi kontaktuar, me shumë gjasa e kemi kontaktuar n.q.s. subjekti ankues ka paraqitur një email nga info@mundësia.al. Nuk jemi duke e mohuar këtë fakt, por edhe sikur të kishim të dhëna, ne sot e kemi aktualisht të pamundur që të verifikojmë apo identifikojmë këtë subjekt, këtë email apo të dhënat e këtij subjekti, si i kemi marrë, si i kemi përdorur, për shkak se, sipas rregullores që ne kemi, në mos gaboj është e përcaktuar diku që pas fushatës, pas përfundimit të zgjedhjeve ne jemi të detyruar të shkatërrojmë çdo lloj të dhëne, çdo lloj dokumenti që i përmban ato, dhe besoj kemi paraqitur dhe dokumentacionin përkatës për asgjësimin dhe shkatërrimin e këtyre dokumenteve. Por që konfirmoj, siç kemi konfirmuar që adresa info@mundësia.al është adresa e subjektit. Ne kemi dorëzuar aktet që rregullojnë fushën e trajtimit të të dhënave personale, jo aktet e brendshme të partisë se si i ka miratuar ato. Siç e thashë autorizimi që më është dhënë mua për të miratuar këto akte dhe për ti hartuar, është bërë në një mbledhje ku kjo, ka qenë aksesore e trajtimit të të dhënave personale. Janë ndarë detyrat në atë mbledhje, janë shumë detyra dhe ne nuk mund t’ju vëmë në dispozicion atë akt sepse është një çështje e partisë që ka marrë disa vendimmarrje që nuk mund të bëhen publike.”*

5. Në lidhje me objektin e ankesës, që ka të bëjë me pretendimin e subjektit të të dhënave për dërgimin e email-it për marketing lidhur me fushatën zgjedhore nga dërguesi “info@mundesia.al”, pa pëlqimin e saj, rezulton se nga provat e administruara ky email administrohet nga Kontrolluesi.

Sa i përket dokumentacionit të subjektit të të dhënave E.Q., përfaqësuesi i Kontrolluesit deklaron se nga ana e Zyrës së Komisionerit nuk i është vënë në dispozicion informacion i plotë lidhur me gjeneralitetet e ankueses, por vetëm inicialet e saj. Ndërsa lidhur me afatet e ruajtjes së të dhënave personale, përfaqësuesi i Kontrolluesit shprehet se, Partia Mundësia në përputhje me afatet e ruajtjes së të dhënave ka fshirë të gjitha të dhënat personale të simpatizantëve të përfshirë në fushatat zgjedhore, menjëherë pas përfundimit të procesit zgjedhor në përputhje me afatin 10 ditor të përcaktuar në nenin 13 “Afatet e ruajtjes dhe asgjësimi” të “Rregullores për Mbrojtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”, të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e asgjësimit.

Për arsyet e sipërcituara, përfaqësuesi i Kontrolluesit shprehet se në kushtet kur janë asgjësuar të dhënat elektronike dhe fizike, është në pamundësi të identifikojë nëse ekziston formular pëlqimi që i përket individit në fjalë.

Në këtë rast, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton të ketë ndonjë akt të firmosur nga subjekti i të dhënave që të vërtetojë dhënien e pëlqimit të qartë, të lirë dhe të informuar për marrjen e njoftimeve elektronike. Në qëndrimet me shkrim, Kontrolluesi deklaron se nuk mund të verifikojë nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për marrjen e komunikimit elektronik, për shkak se të dhënat përkatëse janë asgjësuar pas përfundimit të fushatës zgjedhore.

Megjithatë, referuar nenit 8 pika 3 të Ligjit, në çdo rast kur përpunimi mbështetet në pëlqim, barrën e provës për vlefshmërinë e tij e mban Kontrolluesi. Asgjësimi i të dhënave në mënyrë të tillë që e bën të pamundur vërtetimin e ligjshmërisë së përpunimit, përbën shkelje të detyrimit për të mbajtur dokumentacion përkatës, si dhe cenon parimin e transparencës dhe të llogaridhënies. Në vlerësim të rrethanave të mësipërme dhe në mungesë të çdo prove dokumentare që të provojë ekzistencën e pëlqimit të vlefshëm për përpunimin e të dhënave të ankueses, rezulton se Kontrolluesi ka vepruar në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies të parashikuara në nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit.

Në këto kushte, nuk provohet se subjekti i të dhënave E.Q., e cila është ankuar pranë Zyrës së Komisionerit, ka dhënë pëlqimin për dërgimin e e-mail-eve, në kundërshtim me parashikimet e germës “a” të pikës 1 të nenit 7 të Ligjit, si dhe me pikën 1 të nenit 8 të Ligjit.

6. Sa i përket konstatimit mbi mangësitë formale të akteve të depozituara nga Kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kontrolluesi “*Partia Mundësia*”, në kuadër të hetimit administrativ rezulton se, ky i fundit

ka paraqitur disa akte rregullatore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, përfshirë Urdhrin nr. 1, datë 12.11.2024 “*Për miratimin e akteve rregullatore dhe normative në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale*”, si dhe Urdhrin nr. 3, datë 13.02.2025 “*Rregullore për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” (dorëzuar në seancë dëgjimore), të cilat janë firmosur nga përfaqësuesi i Kontrolluesit dhe mbajnë vulën e Kontrolluesit. Megjithatë, dokumentacioni i bashkëlidhur këtyre urdhrave, konkretisht rregulloret dhe formularët përkatës janë paraqitur pa firmë dhe pa vulë, duke mos përmbushur kriteret minimale të formës dhe autenticitetit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se është autorizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm për të hartuar dhe miratuar akte që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, por refuzoi të vërë në dispozicion aktin e delegimit, me argumentin se përmban çështje të brendshme të partisë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky qëndrim nuk përputhet me detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit, të cilat ngarkojnë Kontrolluesin me detyrimin për të dokumentuar masat organizative dhe teknike që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe për të vënë në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës çdo provë që vërteton përputhshmërinë me Ligjin.

Për më tepër, pika 9.1 dhe pika 9.4, e nenit 9 të “*Statutit të Partisë Mundësia*”, (në vijim, “*Statuti*”) përcakton se, është Kryetari i Partisë subjekti që përfaqëson partinë dhe është i autorizuar për të nxjerrë urdhra dhe udhëzime në zbatim të Statutit dhe vendimeve të organeve drejtuese. Në mungesë të një akti formal delegimi nga Kryetari ose ndonjë organ tjetër kompetent, nënshkrimi i urdhrave të sipërpërmendur nga përfaqësuesi i kontrolluesit mbetet pa bazë ligjore për të krijuar efekt juridik jashtë partisë, veçanërisht për individë që nuk janë pjesë e saj. Vula e vendosur në urdhrat e përmendur nuk zëvendëson mungesën e kompetencës formale, ndërsa rregulloret dhe formularët pa firmë e vulë nuk mund të konsiderohen si dokumente të vlefshme, as për nga forma dhe as për nga funksioni.

Po kështu, Zyra e Komisionerit e gjen të drejtë prapësimin e përfaqësuesit të kontrolluesit ku shprehet se duke qenë se nuk është autoritet publik apo ent administrativ në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, nuk i nënshtrohet parashikimeve të kodit mbi formën e akteve.

Lidhur me këtë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në kushtet kur kontrolluesi mbart cilësinë e personit juridik, atëherë aktet e përpiluara nga ana e tij kanë karakteristikat e shkresës së thjeshtë, të cilat rregullohen nga neni 258 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Partitë politike, sipas përcaktimit të nenit 16 të ligjit nr. 8580/2000 “*Për partitë politike*”, i ndryshuar, janë subjekte me status personi juridik, të cilat gëzojnë pasuri dhe kapacitet për të zhvilluar veprimtarinë e tyre politike, organizative dhe financiare. Si person juridik, partia politike ka subjektivitet të plotë për të nxjerrë akte që organizojnë jetën e

brendshme dhe ndërveprimet e saj me të tretët, përfshirë akte që mund të prodhojnë efekt juridik në raport me individët, institucionet apo autoritetet mbikëqyrëse.

Për më tepër, neni 9, paragrafi i parë i ligjit për partitë politike, përcakton se regjistrimi i partive politike bëhet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një regjistër të posaçëm, ku ndër të tjera shënohet edhe konfiguracioni i vulës dhe emri i kryetarit të partisë. Këto elemente identifikuese nuk kanë thjesht rëndësi informative, por përbëjnë edhe elementë thelbësorë për provueshmërinë e origjinalitetit dhe autentifikimin e dokumenteve të lëshuara në emër të partisë politike.

Në këtë kontekst, kur kontrolluesi i referohet një dokumenti apo akti të vetin të brendshëm si provë përpara një autoriteti publik, çështja e vlefshmërisë së këtij dokumenti kalon në sferën e provës, e cila në mungesë të rregullimit të veçantë, i nënshtrohet standardeve të përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Duke u bazuar në sa më sipër, rezulton se aktet e nxjerra nga Kontrolluesi, për të qenë të vlefshme si dokumentacion zyrtar dhe për të prodhuar efekt juridik, duhet të përmbushin kushtet formale të vlefshmërisë, përfshirë firmën e përfaqësuesit të regjistruar ligjërisht dhe vulën e partisë, siç është e depozituar në regjistrin gjyqësor sipas nenit 9 të ligjit për partitë politike.

Sa më sipër, në mungesë të firmës së personit kompetent dhe vulës zyrtare, aktet në fjalë nuk e përmbushin standardin e *“shkresës së provueshme”* dhe nuk mund të kenë vlerë provuese përballë autoriteteve apo palëve të treta. Ky qëndrim është i mbështetur si në ligjin e posaçëm për partitë politike, ashtu edhe në normat procedurale civile të cilat zbatojnë rregullat mbi provën për aktet e subjekteve me personalitet juridik.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në kushtet kur aktet e pretenduara rregullatorë, mbi bazën e të cilave Kontrolluesi ka deklaruar se ka kryer asgjësimin e të dhënave personale, nuk përmbushin kriteret e vlefshmërisë në formë dhe përfaqësim, si pasojë e mungesës së firmës dhe vulës së autoritetit/organit kompetent në dokumentacionin shoqërues, si dhe mungesës së një akti të dokumentuar delegimi kompetencash, procesverbali i asgjësimit nuk mund të vlerësohet si një akt i ligjshëm.

Në përfundim, në zbatim të nenit 93 të Ligjit, Komisioneri vendos sanksione administrative në përputhje me këtë nen për shkeljet e këtij Ligji, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 94 të Ligjit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet

administrative, në mënyrë të tillë që të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Zyra e Komisionerit, konsideron dy elementë thelbësorë në përcaktimin e pikënisjes për përllogaritjen e e sanksionit:

- i. *kategorizimin e shkeljeve sipas natyrës referuar nenit 94, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;*
- ii. *shkallën e rëndësisë së shkeljeve bazuar në pikën 2 të nenit 93, të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Për përcaktimin e masës së administrative, Komisioneri ka parasysh faktin se, partitë politike janë institucione të së drejtës kushtetuese dhe një shtyllë thelbësore e organizimit demokratik, si dhe merr në konsideratë faktin që sanksionimi i tyre nuk duhet të ketë efekte penguese apo cenuese ndaj funksionit të tyre demokratik, të drejtës për organizim politik dhe pjesëmarrjes së lirë në jetën publike.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, “*Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative*”, veçanërisht në pikat 7 dhe 8 të Seksionit 2.3 të Kapitullit 2, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret duhet të merren parasysh disa faktorë.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Zyra e Komisionerit evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e subjektit të hetuar, gatishmërinë e treguar për rikuperimin e shkeljes, si dhe natyrën e veçantë të subjektit, i cili përfaqëson një parti politike. Kjo e fundit përbën një element me rëndësi të veçantë në kuadër të ruajtjes së balancës ndërmjet efektivitetit të masës administrative dhe moscenimit të funksionit të subjektit si pjesë përbërëse e rendit demokratik.

Për rrjedhojë, këto rrethana vlerësohen në favor të vendosjes së një mase administrative të moderuar, në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe të parandalimit, pa ndikuar në mënyrë të pajustificuar në ushtrimin e së drejtës për organizim politik.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 13, 27, 28, 81, 82, 83, 84, 93, si dhe germa “a”, pika 2 e nenit 94 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit, për përpunimin e të dhënave pa një bazë

të vlefshme ligjore, përfshirë mungesën e pëlqimit të informuar dhe të dokumentuar të subjekteve si dhe mosrespektimin e kushteve dhe garancive të kërkuara nga ligji;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa konkrete për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, përmes aplikimit të “*Formularit të Pëlqimit*”, në mënyrë që të informojë subjektet e të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa konkrete në mënyrë që të sigurojë mbajtjen e dokumentacionit për veprimtarinë e përpunimit të të dhënave, me qëllim që të jetë në gjendje të demonstrojë përputhshmërinë me kërkesat e nenit 27 të Ligjit;
5. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave organizative specifike, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave, si dhe të vendosë rregulla të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 28 të Ligjit;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
 - i. menjëherë, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
 - ii. vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 4;
 - iii. brenda 30 ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 5;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
8. Gjobat arkëtohen nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 01.08.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi